


Dr. Sufeparimët.

B2 28/5/2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



Dur. Inzidentes

Të inspektohet raport

Per lehterisë së
mofshije të mëtejshme

Nr. 94, datë 20.5.2019

PËR

NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit nr.500, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, dhe të pikave 3 e 7, të kreut VIII, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,

U R D H Ë R O J:

I. GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Krijimin e grupeve ndërinstucionale të punës për integrimin evropian (në vijim, GNPIE) për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian, duke përfshirë kapitullin e kriterit politik dhe kapitullin e kriterit ekonomik, si më poshtë vijon:
 - a) GNPIE, kapitulli “Kriteri politik”;
 - b) GNPIE, kapitulli “Kriteri ekonomik”;
 - c) GNPIE, kapitulli 1, “Lëvizja e lirë e mallrave”;
 - ç) GNPIE, kapitulli 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”;

- d) GNPIE, kapitulli 3, “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”;
- dh) GNPIE, kapitulli 4, “Lëvizja e lirë e kapitalit”;
- e) GNPIE, kapitulli 5, “Prokurimi publik”;
- ë) GNPIE, kapitulli 6, “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”;
- f) GNPIE, kapitulli 7, “E drejta e pronësisë intelektuale”;
- g) GNPIE, kapitulli 8, “Politika e konkurrencës”;
- gj) GNPIE, kapitulli 9, “Shërbimet financiare”;
- h) GNPIE, kapitulli 10, “Shoqëria e informacionit dhe media”;
- i) GNPIE, kapitulli 11, “Bujqësia dhe zhvillimi rural”;
- j) GNPIE, kapitulli 12, “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve”;
- k) GNPIE, kapitulli 13, “Peshkimi”;
- l) GNPIE, kapitulli 14, “Politika e transportit”;
- ll) GNPIE, kapitulli 15, “Energjia”;
- m) GNPIE, kapitulli 16, “Tatimet”;
- n) GNPIE, kapitulli 17, “Politikat ekonomike dhe monetare”;
- nj) GNPIE, kapitulli 18, “Statistikat”;
- o) GNPIE, kapitulli 19, “Politikat sociale dhe të punësimit”;
- p) GNPIE, kapitulli 20, “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”;
- q) GNPIE, kapitulli 21, “Rrjetet transevropane”;
- r) GNPIE, kapitulli 22, “Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore”;
- rr) GNPIE, kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”;
- s) GNPIE, kapitulli 24, “Drejtësia, liria dhe siguria”;
- sh) GNPIE, kapitulli 25, “Shkenca dhe kërkimi shkencor”;
- t) GNPIE, kapitulli 26, “Arsimi dhe kultura”;
- th) GNPIE, kapitulli 27, “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”;
- u) GNPIE, kapitulli 28, “Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik”;
- v) GNPIE, kapitulli 29, “Bashkimi doganor”;
- x) GNPIE, kapitulli 30, “Marrëdhëniet me jashtë”;
- xh) GNPIE, kapitulli 31, “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”;
- y) GNPIE, kapitulli 32, “Kontrolli finanziar”;
- z) GNPIE, kapitulli 33, “Dispozitat financiare dhe buxhetore”.

II. FUSHA E VEPRIMIT DHE DETYRAT E GNPIE-SË

1. Fusha e veprimit të çdo GNPIE-je përcaktohet nga përbajtja tematike e kapitullit të *acquis*, përfshire kapitujt “Kriteri politik” dhe “Kriteri ekonomik”.

2. Për realizimin e përgjegjësive të përcaktuara në vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, secila GNPIE të kryejë këto detyra kryesore në fushën e përgjegjësisë së saj:
- a) Të përcaktojë përgjegjësinë për harmonizimin e zbatimin e *acquis* për kapitullin përkatës te institucionet përgjegjëse dhe të adresojë mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet tyre;
 - b) Të bashkërendojë përgatitjen dhe përditësimin e analizës së mangësive ligjore për çdo pjesë të *acquis*, bazuar në kontributin e institucioneve/drejtoreve përgjegjëse;
 - c) Të identifikojë aktorët e interesuar për pjesë të caktuara të procesit të negociatave;
 - c) Të bashkërendojë përgatitjen e prezantimit të situatës aktuale të kapitullit përkatës të *acquis*, në kuadër të procesit “*screening*” dypalësh;
 - d) Të bashkërendojë përgatitjen e informacionit për projektraportin “*screening*” për kapitullin përkatës të *acquis*, në procesin e negociatave, të përgatitur nga Komisioni Evropian, si dhe çdo raport tjetër shpjegues që nevojitet për të komentuar ose për të mbështetur deklaratat në këtë informacion, bazuar në kontributin e institucioneve/drejtoreve përgjegjëse për çdo pjesë të *acquis*;
 - dh) Të bashkërendojë përgatitjen e qëndrimit negocies për kapitullin përkatës të *acquis*, bazuar në kontributin e institucioneve/drejtoreve përgjegjëse për çdo pjesë të *acquis*;
 - e) Të bashkërendojë përgatitjen e projektplanit të veprimit për realizimin e detyrave në mbështetje të procesit të hapjes së negotiatave për kapitullin përkatës të *acquis*, në përgjigje të kërkesës së Komisionit Evropian;
 - ë) Të monitorojë dhe të raportojë përbashjen e planit të veprimit për realizimin e detyrave në mbështetje të kapitullit negocies përkatës, sipas nevojës;
 - f) Të bashkërendojë përgatitjen e informacionit ndaj projektqëndrimit të përbashkët lidhur me kapitullin negocies, si dhe çdo dokument tjetër mbështetës që kërcohët;
 - g) Të administrojë e të shpérndajë informacionin lidhur me fazën përgatitore dhe procesin e negotiatave;
 - gj) Të bashkërendojë përgatitjen e raporteve informative ose tematike për kapitullin përkatës të *acquis*, sipas kërkesës;
 - h) Të bashkërendojë procesin e identifikimit të nevojave për asistencë teknike në kuadër të negotiatave për anëtarësimin;
 - i) Të kryejë vlerësimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të saj e të dërgojë këtë vlerësim pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Sekretariatit për Integrinë Evropiane, për planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të nevojshme;

- j) Të bashkërendojë informacionin për planifikimin dhe nevojën për përkthimin e *acquis* përkatës për kapitullin negociues;
 - k) Të bashkërendojë procesin e hartimit e të përditësimit çdo vit për kapitullin përkatës të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (në vijim, PKIE), si dhe çdo dokumentacion apo informacion tjetër për këtë qëllim dhe merr pjesë në çdo aktivitet të strukturave përkatëse, në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit, nën koordinimin e Sekretariatit të Integrimit Evropian;
 - l) Të bashkërendojë procesin lidhur me sigurimin e përputhjes së PKIE-së me politikat e tjera dhe dokumentet strategjike në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet GNPIE-ve lidhur me fushën e veprimtarisë dhe të *acquis* përkatës zgjidhen me dakordësinë e kryetarëve të GNPIE-ve. Në rast të mosarritjes së një dakordësie, mosmarrëveshja zgjidhet me vendim të Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (në vijim, KTGNP).

III. PËRBËRJA E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Çdo GNPIE përbëhet nga:

- a) kryetari;
- b) zëvendëskryetari;
- c) sekretari i përhershëm;
- ç) anëtarët përfaqësues nga secili institucion kontribues për atë kapitull;
- d) anëtarë përfaqësues i Sekretariatit të Integrimit Evropian (në vijim, koordinatori);
- dh) anëtarë përfaqësues nga ministria përgjegjëse për fushën e financave;
- e) anëtarë përfaqësues nga Instituti i Statistikave (INSTAT);
- ë) anëtarët përfaqësues të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit.

2. Institucioni përgjegjës për kryesimin e secilit kapitull të *acquis* dhe institucionet kontribuese për atë kapitull përcaktohen në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kryetari dhe zëvendëskryetari i GNPIE-së propozohen nga institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit. Kryetari i GNPIE-së mund të jetë një zëvendësministër ose sekretari i përgjithshëm i ministrisë, drejtuesi apo sekretari i përgjithshëm i institucionit të pavarur apo përkatësisht drejtuesi i institucionit të varësisë, përgjegjës për kryesimin e kapitullit.

Zëvendëskryetari i GNPIE-së është nëpunës i nivitet drejtues të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit.

4. Anëtarët që propozohen nga institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit apo institucioni kontribues janë nëpunës të vetë institucionit, si rregull, të strukturave përgjegjëse për zhvillimin e politikave e strukturave rregullatore, apo mund të jenë edhe persona me ekspertizën përkatëse jashtë institucionit.
5. Çdo institucion përgjegjës për kryesimin e kapitullit apo institucion kontribues propozon numrin e nevojshëm të anëtarëve për të mbuluar çdo pjesë të *acquis* për të cilin është përgjegjës, por jo me pak se 2 (dy) anëtarë për çdo nënkapitull të *acquis*, për të cilin institucioni kontribuon.
6. Anëtari përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat propozohet nga ministri përkatës, ndërsa anëtari përfaqësues nga Institut i Statistikave (INSTAT) propozohet nga titullari i INSTAT-it.
7. Sekretari i Përherershëm i GNPIE-së është një nga nëpunësit e strukturës së integrimit evropian, të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit, propozuar nga ky institucion.
8. Për çdo anëtar, përfshirë sekretarin e përherershëm, institucioni propozon, gjithashtu, një anëtar zëvendësues që zëvendëson anëtarin kryesor në rast pamundësie të përkohshme të këtij të fundit.
9. Përbërja nominale e anëtarëve të GNPIE-së, përfshirë emrat e anëtarëve “zëvendësues”, miratohet me urdhër të Kryeministrat, me propozimin e ministrit ose titullarit të institucionit përgjegjës për drejtimin e GNPIE-së. Urdhri përditësohet sipas nevojës, por jo më pak se një herë në vit.

IV. RREGULLAT E PUNËS SË GNPIE-SË

1. GNPIE-ja funksionon në mënyrë të përherershme dhe kryen detyrat e përcaktuara në këtë urdhër me kontributin e secilit anëtar të tij, sipas pjesës përkatëse të përgjegjësisë për *acquis*. Çdo anëtar i GNPIE-së drejton e koordinon punën e strukturave të institucionit që përfaqëson për realizimin e detyrave të GNPIE-së, për pjesën përkatëse të *acquis*, që është ngarkuar të mbulojë.
2. Organizimi dhe koordinimi i punës së GNPIE-së realizohen nga kryetari i GNPIE-së, në konsultim me anëtarin e grupit negociator, përgjegjës për kapitullin përkatës (në vijim, negociatori).

3. Në kryerjen e detyrave të tij, kryetari mbështetet nga nënkyretari, i cili zëvendëson kryetarin në rast të pamundësisë së përkohshme apo kryen detyra specifike të caktuara nga kryetari.
4. Për organizimin e punës, ndarjen e detyrave, diskutimin dhe dakordësimin e qëndrimeve për çështje të caktuara, GNPIE-ja zhvillon mbledhje të përgjithshme apo mbledhje tematike. Mbledhjet tematike mund të mbahen edhe për nënkapituj të *acquis* apo çështje të caktuara.
5. Mbledhjet e përgjithshme zhvillohen të paktën 1 (një) herë në 2 (dy) muaj. Mbledhjet tematike mbahen sipas nevojës ose në përputhje me dinamikën e caktuar nga GNPIE-ja.
6. Dakordësimi i qëndrimeve të anëtarëve të GNPIE-së për çështje të caktuara bëhet në një mbledhje të përgjithshme apo tematike të GNPIE-së, me konsensus të anëtarëve. Në rast të mosarritjes së një dakordësie, mosmarrëveshja zgjidhet me vendim të KTGNP-së.
7. Mbledhja e GNPIE-së thirret nga dhe sipas rendit të ditës të përcaktuar nga kryetari i GNPIE-së, me iniciativë të vetën, me kërkesë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të kryenegociatorit, të anëtarit të grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës apo me kërkesën e të paktën 5 (pesë) anëtarëve të GNPIE-së.
8. Në mbledhjen e GNPIE-së kanë të drejtë të marrin pjesë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryenegociatori, anëtarët e grupit negociator, përfaqësues të Kuvendit dhe përfaqësues të strukturës përkatëse për kodifikimin në Ministrinë e Drejtësisë.
9. Në mbledhjet e GNPIE-së, sipas nevojës, ftohen të marrin pjesë, përfaqësues nga akademia, biznesi, shoqëria civile, si dhe përfaqësues të tjere nga grupet e interesit, sipas vlerësimit të kryetarit të GNPIE-së.
10. GNPIE-ja mund të krijojë nëngrupe pune për nënkapituj të kapitullit përkatës të *acquis* apo çështje specifike në fushëveprimin e tij. Nëngrupet e punës krijojnë me vendim të kryetarit të GNPIE-së.
11. Nëngrupi i punës ngarkohet të përgatisë materiale ndihmëse për çështjet specifike dhe t'i paraqesë ato në GNPIE, si dhe i raporton rregullisht për veprimtarinë e tij kryetarit të GNPIE-së përkatëse.

12. Në vendimin për ngritjen e nëngrupit të punës përcaktohen çështjet, detyrat, asfatet, anëtarësia dhe anëtari i ngarkuar për drejtimin dhe koordinimin e nëngrupit të punës.
13. Anëtarët e GNPIE-së janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e GNPIE-së dhe kanë të drejtë të diskutojnë e të marrin pjesë në dakordësimin e qëndrimeve.
14. Anëtarët e GNPIE-së apo të nëngrupeve kanë të drejtën e qasjes në informacion e dokumente, që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave në GNPIE.
15. Anëtarët e GNPIE-së apo të nëngrupeve detyrohen të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme.
16. Përjashtimisht, në rast pamundësie për të marrë pjesë në një mbledhje, anëtari i GNPIE-së njofton paraprakisht, nëpërmjet sekretarit të përhershëm, kryetarin e GNPIE-së. Edhe në këtë rast anëtari ka mundësi të paraqesë, me shkrim, përfshirë në mënyrë elektronike, mendimin e tij për çështjet në rendin e ditës.
17. Në rast se një anëtar i GNPIE-së mungon në mënyrë të përsëritur në mbledhjet e GNPIE-së dhe nuk kryen detyrat ose shkel rregullat e punës sipas këtij urdhri, kryetari i GNPIE-së ka të drejtë të propozojë zëvendësimin e tij.
18. Kryetari i GNPIE-së harton çdo 2 (dy) muaj një raport periodik për veprimtarinë e GNPIE-së, sipas formatit të përcaktuar nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Raporti i paraqitet ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, titullarit të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit, kryenegociatorit dhe anëtarit të grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës.
19. GNPIE-ja harton e miraton çdo 6 (gjashtë) muaj një raport për progresin për kapitullin përkatës. Formati i raportit përcaktohet nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Raporti publikohet në faqen *on-line* të institucionit përgjegjës për kapitullin.
20. Publiku mund të informohet për punimet e GNPIE-së nëpërmjet ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryenegociatorit, një anëtari të grupit negociator, kryetarit të GNPIE-së apo një anëtari të GNPIE-së të autorizuar shprehimisht nga kryetari.

V. MBËSHTETJA E PUNËS SË GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Struktura përgjegjëse për integrimin evropian në institucionin përgjegjës për kryesimin e kapitullit të GNPIE-së vepron si sekretariat i GNPIE-së, duke i siguruar mbështetje teknike e administrative dhe koordinimin e strukturave të institucionit përgjegjës dhe institacioneve të varësisë.
2. Institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit vë në dispozicion ambientet dhe infrastrukturën tjeter të nevojshme për zhvillimin e punimeve të GNPIE-së.
3. Sekretariati i Integrimit, nëpërmjet koordinatorit përkatës, është përgjegjës për mbështetjen teknike dhe shqyrtimin e dokumenteve të përgatitura nga GNPIE-të, sipas detyrave të referuara në pikën 2, të kreut II, të këtij urdhri, si dhe koordinimin e ndërveprimit ndërmjet GNPIE-së dhe grupit negociator.

VI. DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrat/ministrave për zbatimin e këtij urdhri.
2. Ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrat/ministrive, të përcaktuara si institacione përgjegjëse për kryesimin e çdo kapitulli, koordinojnë punën për mbledhjen e propozimeve për anëtarët e GNPIE-së nga institucionet kontribuese dhe propozojnë anëtarët për secilën GNPIE, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Ministria dhe institucioni qendror në varësi të Kryeministrat/ministrave, që ka rolin më të rëndësishëm për kapitullin përkatës, në rastin kur institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit është një institucion i pavarur, koordinon punën për mbledhjen e propozimeve për anëtarët e GNPIE-së nga institucioni kryesues dhe institucionet e tjera kontribuese dhe përgatit listën përfundimtare të anëtarëve për secilën GNPIE, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
4. Ftohen institucionet e pavarura, të përcaktuara si institucion përgjegjëse për kryesimin e çdo kapitulli apo si institucion kontribues, të propozojnë anëtarët e tyre për secilën GNPIE, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Urdhri nr.107, datë 28.2.2014, i Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

SHTOJCA NR.1: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE KRYESUESE DHE KONTRIBUESE PËR SECILIN KAPITULL

Kapitulli	Nënkapitulli	Institucioni Kryesues	Institucionet kontribuesë
Kapitulli "Kriteri politik"	<p>1. Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike <i>demokracia; reforma në administratën publike</i></p> <p>2. Shteti i së drejtës</p> <p>3. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</p> <p>4. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;</p> <p>Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);</p> <p>Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPK);</p> <p>Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (KLGJ);</p> <p>Kryeministria (KM);</p> <p>Departamenti i Administratës Publike (DAP);</p> <p>Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC);</p> <p>Ministria e Brendshme (MB);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastimit të Parave (DPPP);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;</p> <p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK);</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);</p> <p>Agjencja Shtetërore e Kadastrës;</p>	<p>Kuvendi; Prokuroria e Përgjithshme (PP);</p> <p>Avokati i Popullit;</p> <p>Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);</p> <p>Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale (KMDHP);</p> <p>Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi (KMD);</p> <p>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;</p> <p>Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);</p> <p>Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPK);</p> <p>Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (KLGJ);</p> <p>Kryeministria (KM);</p> <p>Departamenti i Administratës Publike (DAP);</p> <p>Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC);</p> <p>Ministria e Brendshme (MB);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastimit të Parave (DPPP);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;</p> <p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK);</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);</p> <p>Agjencja Shtetërore e Kadastrës;</p>

Kapitulli "Kriteri Ekonomik"	1. Ekzistencë e një ekonomie tregu funksionale 2. Aftësia për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Drejtësisë Banka e Shqipërisë (BSH); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes (MSHMSoc); Ministria e Drejtësisë (MD);	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Instituti i Statistikave (INSTAT)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Zyra e Kryeministrat
Kapitulli 1 "Lëvizja e Lirë e Mallrave"	1. Paramet e përgjithshme; 2. Çështjet horizontale; standardizimi; vlerësimi i konformitetit; akreditimi; metrologjia; mbikëqyrja e tregut.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Kulturës (MK); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Mbrojties (MMb);		

3. Direktivat e përqasjes së vjetër;	re dhe globale;	5. Masat procedurale	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Instituti i Statistikave (INSTAT); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ministria e Brendshme (MB); Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS); Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM); Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); Ministria e Drejtësisë; Policia e Shtetit;
Kapitulli 2 “Lëvizja e Lirë e Punëtorëve”	1. Aksesi në tregun e punës; 2. EURES 3. Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore 1. 4. Karta e Evropiane e Sigurimit Shëndetësor	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Ministra e Brendshme (MB); Instituti i Statistikave (INSTAT); Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc);
Kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”	1. E drejta e themelimit 2. Liria për të ofruar shërbime ndërkufitarë; 3. Shërbimi postar;	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

4. Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale		<p>Ministria e Drejtësisë (MD);</p> <p>Ministria e Kulturës (MK);</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotijes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Brendshme (MB);</p> <p>Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);</p> <p>Ajencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHD);</p> <p>Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore; (QKIPK);</p> <p>Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);</p> <p>Instituti i Statistikave (INSTAT). Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);</p> <p>Ajencia e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor (AKSHD);</p> <p>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPDI);</p> <p>Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP);</p> <p>Qendra e Edukimit Shkencor (CES);</p> <p>Ajencia Kombëtare e Formimit Professional (AKFP);</p> <p>Banka e Shqipërisë</p>
Kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e Kapitalit"	<ol style="list-style-type: none"> Regjimi i lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave aktuale; Sistemi i pagesave; Parandalimi i pastrimit të parave 	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP);</p> <p>Ministria e Drejtësisë (MD);</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);</p> <p>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);</p> <p>Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>

Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”	1. Parimet e përgjithshme 2.Dhënia e kontratave publike 3. Mjetet ligjore	Ajencja e Prokurimit publik	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Brendshme (MB); Komision i Prokurimit Publik (KPP); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ajencja e Blejeve të Përqendruara (ABP); Ajencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATK); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP); Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (DSIK); Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 6 “Legjisacioni për Shoqërië Tregtare”	1. Legjisacioni tregtar; 2. Kontabiliteti dhe auditimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK); Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP); Banka e Shqipërisë (BSH); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMSip)
Kapitulli 7 “E drejta e Pronësisë Intelektuale”	1. E drejta e autorit dhe të drejfat e lidhura me të Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPI); 2. Të drejfat e pronësisë industriale 3. Zbatimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPI);	Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Prokuroria e Përgjithshme (PP);

			Shkolla e Magjistraturës; Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Drejtësisë (MD); Drejtoria e Përgithshme e Tatimeve (DPT); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Instituti i Statistikave (INSTAT)
Kapitulli 8 "Politika e Konkurrencës"	<ul style="list-style-type: none"> 1. Politika e konkurrencës duke përfshirë përqendrimin e ndërmarrjeve; 2. Ndihma shtetërore 1. 3. Liberalizimi 	Autoriteti i Konkurrencës	<p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmartjes (MSHMSip); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Kulturës (MK); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>
Kapitulli 9 "Shërbimet Financiare"	<ul style="list-style-type: none"> 1. Bankat dhe konglomeratët financiarë 2. Siguracionet dhe pensionet; 3. Infrastruktura e tregut financiar 4. Bursa dhe shërbimet e investimeve 	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	<p>Banka e Shqipërisë (BSH); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT). Agjencia e Sigurimit te Depozitave</p>
Kapitulli 10 "Shoqëria e digital Informacionit dhe Media"	<ul style="list-style-type: none"> 1. Strategja e tregut unik digital 2. Komunikimet elektronike dhe teknologjia e 	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	<p>Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Ministria e Brendshme (MB); Policia e Shtetit</p>

Komunikimit informacionit (TKI); 3. Shoqëria e informacionit; 4. Politika audiovizive	dhe e komunikimit informacionit (TKI); 3. Shoqëria e informacionit; 4. Politika audiovizive	Agjencja Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSH); Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;	Agjencja Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSH); Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCESK); dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
Kapitulli 11 “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”	1. Çëshjet horizontale mështetja e drejiperdrejtë; financimi i poliiikës të përbashkët bujqësore – CAP (Fondi Evropian i Garancisë Bujqësore – EAGF, Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural- EAFRD; Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit- IACS; agjencia e pagesave; mekanizmat e tregtisë; letrat me vlerë; Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit bujqësor (FADN); rdhmat shtetërore;	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Drejtësisë (MD) Agjencja Shtetëore e Kadastrës (AK); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)	Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH); Instituti i Statistikave (INSTAT)

	<p><i>jo të aneksit I;</i> <i>të ndryshme.</i></p> <p>2. Organizimi i Tregut të Përbashkët;</p> <p><i>bimët e arave, fibra,,</i> <i>drithëra,</i> <i>ushqim i thate, fara</i> <i>vajore, kultura</i> <i>proteine,</i> <i>niseshëte patateje</i> <i>oriz,</i> <i>liri dhe kërpi,</i> <i>pambuku, krimbat e</i> <i>mëndafshit,</i> <i>sheqeri</i></p> <p>3. Prodhimi shtazor;</p> <p><i>qumështi dhe produkte</i> <i>me bazë qumështi;</i> <i>mishi i viçit;</i> <i>mish i deleve dhe</i> <i>dheneve</i> <i>mishi i derrit</i> <i>vezët, mish i pulës</i> <i>mjalti</i></p> <p>4. Bimët/kulturat e specializuara;</p> <p><i>vera dhe alkooli;</i> <i>frutat dhe perimet,</i> <i>banamet;</i> <i>florikultura;</i></p>
--	--

	<p><i>vaj i ullrit;</i> <i>duhani;</i> <i>farat;</i> <i>hopsi.</i></p> <p>5. Zhvillimi rural; 6. Politika e cilësisë; 7. Produktet organike;</p>		
Kapitulli 12 "Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve"	<p>1. Çështje të përgjithshme ushqyesit (Rreg. Ligi për ushqimin dhe ushqimore, 178/2002) Komiteti Autoriteti Evropian për Sigurinë Ushqimore Trajnim</p> <p><i>Aktet e aderimit</i></p> <p>2. Politika veterinare; sistemi i kontrollit në tregun e brendshëm; sistemi i kontrollit për importet identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe regjistrimi i lëvizjeve të tyre; masat e kontrollit për sëmundjet e kafshëve; tregtia brenda BE-së në farë; vezë dhe</p>	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)</p> <p>Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)</p> <p>Ajencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes sëbimëve (ARSHVMB)</p>	<p>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)</p> <p>Instituti i Statistikave (INSTAT);</p>
			<p>Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)</p> <p>Ajencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes sëbimëve (ARSHVMB)</p>

	<p><i>embrione të kafshëve</i> <i>të gjallta;</i> <i>lëvizja jo për arsyen</i> <i>tregtare e kafshëve</i> <i>shëpiakë;</i> <i>ndalimi i substancave</i> <i>dhe kontrolli i</i> <i>mbetjeve;</i> <i>kriteret e importit për</i> <i>kafshët e gjallta dhe</i> <i>nënpoduktet e tyre;</i> <i>marrëveshjet</i> <i>ndërkombëtare të BE-</i> <i>së;</i> <i>mirëgenia e kafshëve;</i> <i>zooteknika;</i> <i>shpenzimet veterinare.</i></p> <p>3. Vendosja në treg e ushqimit, ushqyesve dhe produkteve shtazore; <i>rregullat e higjienës;</i> <i>rregulla të posaçme</i> <i>për produktet</i> <i>shtazore;</i> <i>rregullat e kontrollit;</i> <i>rregullat e posaçme të</i> <i>kontrollit për</i> <i>produktet shtazore;</i></p>
--	--

	<p><i>rregullat për nënprouktet shtazore; financimi i kontrolleve; rregullat e posaçme për higjenën e ushqyeseve.</i></p>
4.	<p><i>Rregullat e sigurisë ushqimore</i></p>
5.	<p><i>Rregullat specifike për ushqyesit</i></p> <p><i>vendosja në treg dhe përdorimi i ushqyeseve;</i></p> <p><i>adiivët e ushqyeseve;</i></p> <p><i>substancat e padëshirueshme;</i></p> <p><i>ushqyesit myekësorë;</i></p> <p><i>marrëveshjet ndërkombëtare komunitare</i></p>
6.	<p><i>Politika fitosanitare;</i></p> <p><i>shëndeti i bimëve (organizmat e dëmshëm, produktet për mbrojtjen e bimëve);</i></p>

Kapitulli 15 “Energjia”	1. Siguria e furnizimit; 2. Tregu i brendshëm i energjisë; 3. Energjia e rinnovueshme 4. Eficiencia e energjisë 5. Investimet në infrastrukturë 6. Energjia bërt hamore 7. Siguria nga energjia bërt hamore dhe mbrojta nga rrezatimet	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Enti Regulator i Energjisë (ERE); Agjencja Kombëtare Bërt hamore; Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet; Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 16 “Tatimet”	1. Tatimi indirekt <i>TVSH akciza</i> 2. Tatimi direkt; 3. Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë 4. Kapaciteti operacional dhe kompjuterizimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
Kapitulli 17 “Politikat ekonomike dhe monetare”	1. Politika monetare; 2. Politika ekonomike	Banka e Shqipërisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 18 “Statistikat”	1. Statistikat demografike dhe sociale 2. Klasifikimet regjistrat dhe 3. Statistikat ekonomike	INSTAT	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Drejtësisë Ministria e Mbrojtjes Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

	4. Statistikat sektoriale 5. Statistikat e njedisit dle <i>multidomain</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise Banka e Shqipërisë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)
Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe të punësimit”	1. Legjislativi i punës; 2. Siguria dhe shëndeti në punë; 3. Dialogu social; 4. Politika e punësimit 5. Fondi Social Evropian; 6. Përfshirja sociale (<i>social inclusion</i>) 7. Mbrojtja sociale 8. Antidiskriminimi 9. Shanset e barabarta	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ISHPSHSH); Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD); Avokati i Popullit; Ministria e Brendshme (MB); Policia e Shtetit Agjencia Shtetërore për të Drejat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve; Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Instituti i Statistikave (INSTAT). Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)
Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”	1. Parimet e politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale 2. Instrumentet e politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale 3. Politikat sektoriale	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);

4. Inovacioni			<p>Autoriteti i Konkurrencës (AK);</p> <p>Banka e Shqipërisë (BSH);</p> <p>Instituti i Statistikave (INSTAT);</p> <p>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise (MASR);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);</p> <p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSSHSH);</p> <p>Ministria e Drejtësisë (MD);</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p> <p>Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)</p> <p>Ministria e Mbrojës</p> <p>Ministria e Kulturës</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)</p> <p>Agjencia e Prokurimit Publik</p> <p>Fondi i Zhvillimit Shqiptar (ADF)</p> <p>Bashkimi i Dhomave të Tregtisë se Shqipërisë (UCCIAL)</p> <p>Këshilli i Investimeve</p> <p>Agjencia e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor (AKSHI)</p> <p>Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)</p> <p>Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)</p> <p>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);</p> <p>Këshilli i Ministrave (Departamenti i Koordinimit te Politikave)</p>
Kapitulli 21 "Rrjetet transevropiane"	1. Rrjetet Evropiane të dhe Energjisë	Ministria e Infrastrukturës	<p>Autoriteti Rrugor Shqiptar;</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave;</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Detar;</p> <p>Enti Rregulator i Energjisë;</p>

			Instituti i Statistikave (INSTAT).
2. Rjetet Evropiane të Energjisë;	3. Rjetet Evropiane të Telekomunikacionit		
Kapitulli 22 “Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore”	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuadri ligjor 2. Kuadri institucional 3. Kapacitet administrative 4. Programimi 5. Monitorimi dhe vlerësimi 6. Menaxhimi dhe kontrolli financiar 	<p>Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Autoriteti i Auditit të Fondeve të Bashkimit Evropian Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Zyra e Kryeministratit Fondi Shqiptar i Zhvillimit</p>	

	Drejtoria e Përgjithshme e Pëmbarimit (DPP); Shërbimi i Provës (SHP); Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH); Ministria e Kulturës (MK); Gjykata e Lartë; Shkolla e Magjistraturës; Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore; (QKIPK); Gjykata Kushtetuese; Departamenti i Administratës Publike (DAP); Komisioni Qendor i Zgjedhjeve (KQZ); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Avokati i Popullit; Avokatura e Shtetit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Instituti i Statistikave (INSTAT); Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Komisioni i Pavarrur i Kualifikimit; Kolegji i Posaqëm i Apelimit; Komisionerët Publikë DAP; Shkolla e Administratës Publike Shqiptare (ASPA); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Agjencia Shëtërore e Kadastrës; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
--	---

Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”	1. Lufta kundër kriminit të organizuar 2. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës; 3. Lufta kundër terrorizmit; 4. Migracioni (i rregullt dhe jo); 5. Azili; 6. Politika e vizave; 7. <i>Shengen</i> dhe kufijtë e jashtëm; 8. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale 9. Sistemi i doganor (referuar në kapitullin 29); 10. Mbrojta e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)	Ministria Brendshme Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Drejtoria e Përgithshme e Tatimeve (DPT); Drejtoria e Përgithshme e Doganave (DPD); Drejtoria e Përgithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP); Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Drejtësisë (MD); Prokuroria e Përgjithshme (PP); Ministria e Mbrojtjes (MMB); Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Ekstremizmit te Dhunshëm; Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë (MIE); Banka e Shqipërisë; Instituti i Statistikave (INSTAT). Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)
Kapitulli 25 “Shkencë dhe kërkimi shkencor”	1. Politikat e kërkimit shkencor dhe inovacionit 2. Programet kuadër 3. Inovacioni dhe hapësira e kërkimit evropian	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Agiencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Agiencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSH); Instituti i Statistikave (INSTAT).

	4. Kërkimi shkencor në fusha specifike		
Kapiulli 26 “Arsimi dhe kultura”	1. Arsimi dhe formimi profesional; 2. Kultura	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA); Qendra e Zhvillimeve Arsimore (QSHA); Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL); Instituti i Statistikave (INSTAT) Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK);	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Kulturës (MK); Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA); Qendra e Zhvillimeve Arsimore (QSHA); Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL); Instituti i Statistikave (INSTAT) Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK);
Kapiulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimaterike”	1. Mjedisi legjislacioni horizontal; cilësia e qirit; menaxhimi i mbetjeve; cilësia e ujit; mbrojja e natyrës; ndotja industriale, menaxhimi i riqeve; kimikatet; mbrojja nga zhurmët; mbrojja e populsisë.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Ministria e Infrastrukturës dhe Enerġijsë (MIE); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Mbrojtjes (MMB); Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve; Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia Kombëtare e Turizmit; Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU); Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor; Instituti i Statistikave (INSTAT).	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Infrastrukturës dhe Enerġijsë (MIE); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Mbrojtjes (MMB); Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve; Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia Kombëtare e Turizmit; Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU); Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor; Instituti i Statistikave (INSTAT).
1. 2. Ndryshimet klimaterike			

<p>Kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik”</p>	<p>1. Mbrojtja e konsumatorit aspektë horizontale; çështje të lidhura me sigurinë e produkteve; çështje jo të lidhura me sigurinë;</p> <p>2. Shëndeti publik aspektë horizontale; kontrolli i duhanit; sëmundjet e transmetueshme; gjaku, indet, qelizat dhe organet; të drejtat e patientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar; shëndeti mendor;</p> <p>3. përcaktimet sociale ekonomike të kujdesit shëndetësor, pubarazia në kujdesin shëndetësor; alkooli, kanceri, shëndeli dhe mijedisi</p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve; Banka e Shqipërisë (BSH); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Inspektorati Shëndetësor Shtetëror; Spitalet universitare; Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjakut; Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave; Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Infrastrukturës dhe Energiës (MIE); Instituteti i Aviacionit Civil (AAC); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Inspektorati i Turizmit (IT); Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Enti Regulator i Energjisë (ERE); Enti Regulator i Ujit (ERU); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Ministria e Drejtësisë; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore</p>
--	---	--	---

Kapitulli 29 “Doganat”	1. Legislacioni doganor 2.Kapacitetet administrative dhe operacionale	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Instituti i Statistikave (INSTAT);
Kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”	<p>1. Politika e përbashkët tregtarë;</p> <p><i>OBT dhe çështje të tjera horizontale; kreditimi i eksporteve; përdorimi i dyfishtë i mallrave.</i></p> <p>2. Marrëveshjet dypalëshe me vendet e tretë;</p> <p>3. Bashkëpumimi për zhvillim</p> <p>4. Ndiarma humanitare</p>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	<p>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);</p> <p>Ministria e Mbrojtjes (MMb);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p> <p>Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE);</p> <p>Emergjencat Civile;</p> <p>Instituti i Statistikave (INSTAT);</p>
Kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”	<p>1. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë - dialogu politik;</p> <p>2. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë dhe mbrojtjes – strategjia politike;</p> <p><i>sankzionet dhe masat kufizuese; paramdalimi i konflikteve;</i></p>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Ministria e Mbrojtjes (MMb); <p>Ministria e MB/Policia e Shtetit</p>

NR.PROT. 2018/2
DATË 23.5 2019

MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA
QENDRORE
KOMITETIT SHTETËROR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

